



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

PËRMBLEDHJE E PROCESVERBALIT
PËR HEDHJEN E SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT
TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI PËR VITIN 2021

Sot më datë **4 dhjetor 2020, ora 11:00**, në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d të Kushtetutës, nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, të Vendimit nr. 413, datë 25.11.2020, të Presidentit të Republikës “Për caktimin e datës për organizimin e procedurës për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Presidenti i Republikës”, si dhe Vendimit nr. 404, datë 25.11.2019, të Presidentit të Republikës “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi””, në Institucionin e Presidentit të Republikës, salla “Skënderbej”, u zhvillua procedura e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, që do të funksionojë përgjatë vitit 2021.

Shorti u hodh në prani të Avokatit të Popullit, zonjës Erinda Ballanca, e cila monitoroi procesin së bashku me përfaqësues nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zoti Alfred Balla, Këshilli i Lartë Gjyqësor, zot Maksim Qoku, Gjykata Kushtetuese, zoti Ermal Tauzi, Kuvendi i Shqipërisë, zonja Mimoza Arbi, si dhe në prani të këshilltares ligjore rezidente pranë OPDAT, zonja Michelle Lakomy.

Procesi i shortit u transmetua direkt e me transparencë të plotë nga Televizioni Publik Shqiptar dhe mediat e tjera të pranishme.

Në përfundim të hedhjes së shortit, rezultoi se anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të përzgjedhur nga shorti, si dhe emrat e anëtarëve zëvendësues, janë si vijon:

Anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që do të funksionojë përgjatë vitit 2021:

1. **Marsida Xhaferllari** nga Gjykata Kushtetuese
2. **Elsa Toska** nga Gjykata Kushtetuese
3. **Ervin Pupe** nga Gjykata e Lartë
4. **Adnan Xholi** nga Prokuroria e Përgjithshme
5. **Astrit Kalaja** nga Gjykatat e Apelit
6. **Elona Toro** nga Gjykatat e Apelit
7. **Gjon Fusha** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
8. **Genti Xholi** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
9. **Rilinda Selimi** nga Gjykatat Administrative

Anëtarë zëvendësues të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

1. **Fiona Papajorgji** nga Gjykata Kushtetuese
2. **Illir Panda** nga Gjykata e Lartë
3. **Kujtim Luli** nga Prokuroria e Përgjithshme
4. **Zegjine Sollaku** nga Gjykata e Apelit
5. **Kleanth Zeka** nga Zyrat e Prokurorive pranë Gjykatave të Apelit
6. **Gentiana Xhelili** nga Gjykatat Administrative

Procedura e hedhjes së shortit u mbyll në datë 4 dhjetor 2020, ora 11.46.

SEKRETARIATI TEKNIK

Znj. Xhensjana Vathi

Z. Andi Hasani

Znj. Sindi Xhuglini